



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

ADGJA.nr.08/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Kryetari i Gjykatës Valon Totaj, duke vendosur përkitazi me ankesën disiplinore të parashtruar nga I.V, nga Vushtrria, me mbrojtësin av.A.K nga Prishtina, ndaj gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit, H.Ç, Xh.A dhe Z.H, lidhur me vendosjen në lëndën PN1.DKR.nr.802/2023, të Gjykatës së Apelit në Kosovë, në kuptim të nenit 9, paragrafi 1.1 dhe 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me datën 24.08.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa disiplinore e parashtruar nga I.V, nga Vushtrria, ndaj gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit, H.Ç, Xh.A dhe Z.H, lidhur me vendosjen në lëndën PN1.DKR.nr.802/2023, të Gjykatës së Apelit në Kosovë.

A r s y e t i m

Me datën 04.08.2023, përmes emailit zyrtar nga Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Gjykata e Apelit e Kosovës, e ka pranuar ankesën (parashtresën informuese) të I.V, nga Vushtrria, të parashtruar nga mbrojtësi i tij av.A.K. Në ankesë (parashtresë) i njëjti ka pretenduar se Gjykata e Apelit ka shkelur afatet e parapara për trajtimin e ankesës ndaj aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda 2023:146869, të datës 05.07.2023, me të cilin është caktuar masa e paraburgimit ndaj ankuesit. Tutje ka theksuar se aktvendimi për caktimin e masës së paraburgimit ndaj ankuesit, nga gjykata e shkallës së parë, është nxjerrë me datën 05.07.2023, ndërsa ankesa është parashtruar pas 24 orëve, gjegjësisht me datën 06.07.2023. Gjithashtu ka theksuar se Prokuroria e Apelit, me datën 27.07.2023, apo 21 ditë me vonesë, ka parashtruar përgjigje ndaj ankesës së I.V, ndërsa Gjykata e Apelit e Kosovës, me datën 27.07.2023, ka nxjerrë aktvendimin PN1.DKR.nr.802/2023, me të cilin e ka refuzuar ankesën e parashtruar nga ankuesi përmes mbrojtësit të tij, të cilin veprim e ka ndërmarr gjithashtu 21 ditë nga dorëzimi i ankesës. Po ashtu ka theksuar se të njëjtit, aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, e kanë

pranuar me datën 02.08.2023, apo pikërisht në ditën e skadimit të aktvendimit mbi caktimin e masës së paraburgimit. Tutje ka theksuar se në arsyetimin e aktvendimit, Gjykata e Apelit nuk e ka sqaruar fare datën në të cilën Prokuroria e Apelit e ka pranuar ankesën ndaj aktvendimit për caktimin e masës së paraburgimit, dhe një fakt i tillë është fshehur qëllimisht për arsye të lajthimit dhe fshehjes së afatit të prokurorisë për të ofruar përgjigjen e saj ndërsa ka theksuar se Prokuroria e Apelit ka pasur në dispozicion afatin prej 24 orësh për të ofruar përgjigjen e saj në raport me pretendimet e mbrojtjes së I.V të prezantuara në ankesë ndërsa Gjykata e Apelit ka pasur në dispozicion vetëm 72 orë për të nxjerrë aktvendimin në fjalë dhe për kundër këtij kufizimi ligjor sikurse përgjigja e Prokurorisë së Apelit e po ashtu edhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit janë nxjerrë 21 ditë pas dorëzimit të ankesës nga ana e mbrojtës. Gjithashtu ka theksuar se ankuesi është privuar nga e drejta e tij për parashtrimin e mjetit të jashtëzakonshëm juridik, më detalisht sikurse në ankesën e tij.

Kryetari i Gjykatës, pas pranimit, vlerësimit të ankesës dhe shkresave të lëndës me datën 07.08.2023, ka kërkuar përgjigje zyrtare nga administratori i gjykatës z.N.A, lidhur me lëndën PN1.DKR.nr.802/2023, ndërsa i njëjti përmes emailit zyrtar të datës 08.08.2023, e ka njoftuar kryetarin e gjykatës se lënda në fjalë në Gjykatën e Apelit përmes sistemit SMIL është pranuar dhe printuar me datën 25.07.2023. Tutje ka theksuar se me datën 26.07.2023, është formuar lënda për Gjykatën e Apelit, e në të njëjtën ditë është dërguar për opinion në Prokurori të Apelit, ndërsa me datën 27.07.2023, opinionin është kthyer nga prokuroria dhe në po të njëjtën ditë lënda i është dorëzuar kolegjit përkatës dhe është votuar. Gjithashtu ka theksuar se me datën 31.07.2023, aktvendimi është dorëzuar në Zyrën për Menaxhimin e Lëndëve dhe përmes sistemit SMIL e njëjta i është përcjellë Gjykatës Themelore në Ferizaj, e cila është e obliguar që të ua përcjellë palëve vendimin e Gjykatës së Apelit.

Kryetari i Gjykatës së Apelit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, ka gjetur se:

- ankesa e ankuesit I.V, është e **pabazuar**.

Kryetari i Gjykatës së Apelit pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar, shkresave të lëndës si dhe përgjigjes zyrtare të administratorit të Gjykatës së Apelit z.N.A, vlerësoi se pretendimet ankimore sa i përket shkeljeve të afateve të parapara për trajtimin e ankesës ndaj aktvendimit për caktimin e masës së paraburgimit, janë pretendime të pabazuara dhe të paqëndrueshme për faktin lënda në fjalë PN1.DKR.nr.802/2023, me numër të SMIL 2023:056749, në Gjykatën e Apelit të Kosovës është pranuar me datën 25.07.2023, ndërsa me datën 26.07.2023, është dërguar për opinion në Prokurorinë e Apelit.

Kryetari i Gjykatës vlerëson se në rastin konkret Gjykata e Apelit me datën 27.07.2023, ka pranuar opinionin nga Prokuroria e Apelit dhe po në këtë datë lënda i është caktuar kolegjit në

përbërje prej gjyqtarëve H.Ç - kryetar kolegji, Xh.A dhe Z.H - anëtar kolegji, të cilët po në këtë datë kanë vendosur lidhur me ankesën ndaj aktvendimit për caktimin e masës së paraburgimit. Andaj, rezulton se Gjykata e Apelit rastin në fjalë e ka trajtuar brenda afateve të përcaktuara sipas dispozitës së nenit 186 paragrafi 3 të Kodit të Procedurës Penale.

Kryetari i Gjykatës ka vlerësuar, se në rrethanat aktuale të çështjes nuk ka bazë për të hapur një hetim disiplinor lidhur me shkeljet e afateve të parapara për trajtimin e ankesës ndaj aktvendimit për caktimin e masës së paraburgimit nga kolegji i lartcekur i Gjykatës së Apelit, meqë me prova të shqyrtuara nuk është vërtetuar se gjyqtarët kanë bërë shkelje të Kodit të Etikës, ngase rasti në fjalë nga kolegji i gjykatës është trajtuar brenda afateve ligjore të paraprirë me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, e po ashtu edhe brenda afatit ligjor i është përcjellë Gjykatës Themelore në Ferizaj, e cila ka për obligim ligjor që palëve t’ua përcjellës vendimet e Gjykatës së Apelit.

Gjithashtu në bazë të nenit 9 paragrafi 4, i Ligjit për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, shprehimisht parashihet se *“Personi fizik apo juridik duhet ta dorëzojë ankesën me shkrim. Ankesa duhet të përmbajë”*, ndërsa nën paragrafi 4.2 parasheh *“identitetin e gjyqtarit ose prokurorit që do të jetë subjekt i hetimit”*. Neni 5 paragrafi 3 i Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve nr.05/2019, të datës 27.05.2019, shprehimisht parasheh se *“çdo ankesë, edhe në qoftë se nuk shënohet shprehimisht si ankesë, do të konsiderohet si e tillë, kur nga përmbajtja del se qëllimi i palës është të paraqes një pretendim për shkelje disiplinore nga ana e gjyqtarit”*. Kryetari i Gjykatës ka vlerësuar se parashtrësia e ankuesit duhet të trajtohet si e rregullt edhe pse e njëjta nuk i përmban elementet siç parashihen me dispozitat e lartcekura, konkretisht shkresa në fjalë është titulluar *“parashtrësë informuese”*, dhe në të nuk është specifikuar emri i gjyqtarit apo gjyqtarëve për të cilin pretendohet se kanë kryer shkelje disiplinore, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimit.

Kryetari i Gjykatës vlerësoi se gjyqtarët janë të pavarur në vendimmarrje, pavarësi kjo e cila i’u është garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Po ashtu gjyqtarët janë të pavarur në punë e tyre, vendosin sipas ligjit dhe vendimet merren në bazë të provave që shqyrtohen dhe verifikohen në shqyrtim kryesor. Sipas vlerësimit të kryetarit, pavarësia individuale, është pavarësia e gjyqtarëve në kryerjen e funksionit të tyre gjyqësor, që nënkupton se gjyqtarët duhet të jenë meritator, objektiv, neutral dhe të liruar nga çdo ndjenjë e ndikimit kur ushtrojnë funksionin e tyre gjyqësor. Për më tepër për punën profesionale të gjyqtarit apo kolegjit, kompetent për vlerësim profesional është Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve i cili vepron në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës, ku i njëjti bën vlerësimin e performancës për gjyqtarët.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit në kuptim të nenit 9, paragrafi 1, pika 1.1. të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtareve dhe Prokurorëve.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
ADGJA.nr.08/2023, me datë 24.08.2023

Kryetari i Gjykatës
Valon Totaj

Vendimi t'i dorëzohet:

- Parashtruesit të ankesës;
- Gjyqtarëve H.Ç, Xh.A dhe Z.H;
- Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Një kopje në shkresa të lëndës.